

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, JANAR 2026						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	5.1.2026	1. A ekziston një Plan i Detajuar Vendor (PDV) i miratuar dhe i harmonizuar me Planin e Përgjithshëm Vendor të Tiranës, i cili sipas legjislacionit shqiptar përbën hapin e parë të domosdoshëm për dhënien e lejes së ndërtimit ? 2. Zona ku po kryhet ndërtimi është e përcaktuar për qëllime publike arsimore.A është bërë publik ndonjë akt zyrtar për ndryshimin e destinacionit të tokës? 3. Përse nuk është bërë publik asnjë raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe asnjë konsultim publik edhe pse ligji e kërkon për projekte të kësaj përmase? 4. Çfarë keni për të thënë rreth konstatimeve të ekspertëve të cilët shprehen se ndërtimi i kampusit të Kolegjit të Europës po ndërtohet mbi parregullsi?	6.1.2026	Kthim përgjigjeje se bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkesa për informacion duhet t’ i referohet një dokumenti nëpërmjet të cilit kërkohet informacion, psh, strategji, ligj, VKM, Urdhër, Udhëzim etj, sepse ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, statistika, për t’ju përgjigjur pyetjeve, për të bërë komente etj.	Përfunduar	Nuk ka
2	12.1.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me financimin dhe vendimmarrjen për projektet e rindërtimit që përfshijnë sistemin e ujërave të shiut në Bashkinë Durrës, në kuadër të interesit publik për përdorimin e fondeve publike dhe qëllimin e investimeve të miratuara pas tërmetit të 26 nëntorit 2019.	13.1.2026	Informohet se infomacioni i kërkuar gjendet në Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 20.9.2021, në të cilën është botuar vendimi lidhur me përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës, si njësi zbatuese.	Përfunduar	Nuk ka
3	12.1.2026	Kërkohet informacion lidhur me zhvillimin e procedurës për emërimin e Kryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare.	16.1.2026	Dërgohet informacion i plotë lidhur me zhvillimin e procedurës për emërimin e Kryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare, bazuar në procesverbalet përkatëse të mbajtura për këtë qëllim.	Përfunduar	Nuk ka
4	16.1.2026	Kërkohet informacion për funksionimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale "Diella".	16.1.2026	Diella është një sistem intelligence, artificiale që është zhvilluar nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) dhe është integruar në platformën e-Albania për të ofruar shërbime publike automatike. Në 15 shtator 2025 është miratuar dekreti që autorizon krijimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale” dhe Diella është “emëruar” Ministere Virtuale e Inteligjencës Artificiale. Duhet sqaruar se Diella përbëhet nga një arkitekturë mikro-shërbimesh që ndërveprojnë me sisteme të tjera ekzistuese shtetërore. Shërbimet e inteligjencës artificiale që ajo përdor ofrojnë asistencë dhe mbështetje analitike në mbledhjen, përpunimin dhe prezantimin e informacionit, në përputhje me praktikën dhe metodologjitë e miratuara për përdorimin e AI në administratën publike. Në këtë kuadër, Diella nuk merr vendime administrative apo ligjore në mënyrë autonome; përgjegjësia formale për çdo akt apo veprim që buron nga përdorimi i saj i mbetet personit ose institucionit që ndërvepron dhe e përdor sistemin për marrjen e vendimeve përfundimtare. Çdo ndërveprim me Diellën është plotësisht i loguar dhe i gjurmueshëm, në përputhje me standardet e transparencës dhe sigurisë së informacionit. Kjo do të thotë se çdo e dhënë e prezantuar apo çdo kërkesë e përpunuar nga sistemi mund të verifikohet retrospektivisht, duke mundur identifikimin e burimit dhe qëllimin e përdorimit të saj.	Përfunduar	Nuk ka
5	21.1.2026	Kërkohet informacion lidhur me raportimin për gjendjen e sigurisë kombëtare gjatë vitit 2024 dhe 2025.	29.1.2026	Deleguar Ministrisë së Mbrojtjes, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
6	26.1.2026	Kërkohet relacioni i vendimit nr.845, datë 30.12.2025 Për krijimin e shoqërisë aksionare "Operatori i shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit".	5.2.2026	Kthim përgjigjeje, bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe në kufizimet e përcaktuara nga neni 17 i ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.	Përfunduar	Nuk ka